



**INSTITUTI ALBANOLOGJIK
PRISHTINË**

**AKADEMIA E SHKENCAVE E
SHQIPËRISË**

Prishtinë, prot. 124, datë 10.06. 2021

Tiranë, prot. 400, datë 10.06.2021

**Marrëveshje bashkëpunimi
ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë
dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës**

**Neni 1
Baza ligjore**

Kjo marrëveshje nënshkruhet në bazë të ligjit nr. 53/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë; të ligjit Për Institutin Albanologjik dhe të ligjit Për veprimtarinë kërkimore-shkencore të Kosovës.

**Neni 2
Përcaktimi i palëve**

Palët në këtë protokoll janë:

Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), e përfaqësuar nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar; Instituti Albanologjik i Prishtinës (më tej: IAP), i përfaqësuar nga prof. dr. Hysen Matoshi, Drejtore.

**Neni 3
Qëllimi**

Marrëveshja ka për qëllim rregullimin e bashkëpunimit ndërinstitucional periodik (për një periudhë jo më pak se dyvjeçare) midis *Palëve*; përcaktimin e

veprimtarive kryesore të bashkëpunimit; të parimeve bazë dhe të mënyrës së zbatimit të tyre; mbështetur në legjislacionin në fuqi në vendet gjegjëse, në parime të gjithëpranuara dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 4 **Parime bazë**

Parime themelore rregulluese për bashkëpunimin e Palëve sipas kësaj marrëveshjeje janë *liria akademike* dhe *autonomia institucionale*. Ato bashkëpunojnë duke respektuar njëra-tjetrën në *vetëveprimin e tyre* të *rregulluar me ligje* dhe *me akte nënligjore*, duke ruajtur dhe zhvilluar traditat më të suksesshme të këtij bashkëpunimi, përmes nismash, projektesh e veprimtarish të përbashkëta akademike e universitare.

Në veprimtaritë e përbashkëta dhe jashtë tyre Palët pranojnë e respektojnë *Kodin europian të sjelljes për integritet në kërkimin shkencor*. Ato mbajnë qëndrim kritik dhe të papajtueshëm ndaj të gjitha formave të plagiaturës dhe manipulimit.

Neni 5 **Drejtimet kryesore të bashkëpunimit**

Palët bashkëpunojnë me përparësi në shkencat albanologjike: *gjuhësi, histori, antropologji kulturore, trashëgimi shpirtërore e identitare, studime letrare e kulturore, shkenca ekonomike e sociale*.

Palët bashkëpunojnë për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume etj.

Palët bashkëpunojnë për kryerjen e studimeve të përbashkëta dhe botojnë ndërsjelltas në buletinet e veta shkencore artikuj të studiuesve të tyre.

Palët bashkëpunojnë për nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj.

Palët shkëmbejnë falas botimet e tyre shkencore dhe dokumentare.

Neni 6 **Veprimtari të parashikuara**

Palët bien dakord që për periudhën 2021-2022 të bashkëpunojnë për këto veprimtari kryesore:

- Kuvendi ndërkontrollor i studimeve albanologjike (nëntor 2021);

- Bashkëpunim për projektet e mëdha të albanologjisë, në formën e autorit pjesëmarrës/bashkautorit pjesëmarrës; recensuesit, anëtarit të redaksisë, redaktorit shkencor e gjuhësor etj.: *Fjalori i madh i gjuhës shqipe, Enciklopedia shqiptare* dhe *Historia e shqiptarëve* (2021-2022-);
- Veprimtaritë kushtuar 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit (2022);
- Veprimtaritë kushtuar 50-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (2022);
- Përfaqësim në komisionet dhe nënkomisionet që veprojnë pranë Këshillit Ndërakademik për Gjuhën Shqipe;
- Veprimitari të tjera me karakter shkencor-jubilar me interes të përbashkët, për të cilat vendimi merret në proces e sipër.

Neni 7
Palë të tjera në bashkëpunim

Kjo marrëveshje ka karakter dypalësh, plotëson marrëdhëni e bashkëpunimit të Palëve mes tyre dhe nuk prek marrëveshjet me të tretë.

Neni 8
Zbatimi dhe kohëzgjatja

Kjo marrëveshje nënshkruhet për një periudhë dyvjeçare dhe, me vullnetin e shprehur me shkrim nga Palët, është i përsëritshëm çdo dy vjet. Marrëveshjes mund t'i bëhen shtesa në proces me mirëkuptim të Palëve.

Palët takohen një herë në vit për të vlerësuar ecurinë e bashkëpunimit.

Ndërprerja e marrëveshjes pranohet prej Palëve në rastet kur:

- Ndryshon statusi ligjor i institacioneve dhe ky ndryshim prek funksionet themelore të tyre, me efekt në Palën tjetër;
- Njëra nga Palët shpreh me shkrim dhe në mënyrë të arsyetuar shqetësimin për cenimin e interesave bazë të saj në procesin e plotësimit të kushteve të saj.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Kjo marrëveshje është çështje dypalëshe. Për paqartësitë dhe ankesat e mundshme Palët nuk kërkojnë apelim në ndonjë instancë tjetër. Moskuptimet midis Palëve zgjidhen me bisedime.

Në rast të mosarritjes së dakordësisë për një periudhë prej gjysmë viti për çështje të diskutueshme, marrëveshja e humbet fuqinë.

Neni 10
Të fundme

Kjo marrëveshje nënshkruhet në shqip në katër kopje, nga dy për secilën Palë.

Për:

**Institutin Albanologjik
Prishtinë**

Prof. dr. Hysen Matoshi

Drejtore



**Akademinë e Shkencave
të Shqipërisë**

Akad. Skënder Gjinushi

Kryetar

